



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**P. nr.924/2018**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit J.M. nga ..., për shkak të veprës penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme, të parashikuar nga neni 403 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1301/2015, datë 31.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 13.05.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Natasa Radovic dhe të pandehurit, të njëjtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa me datë 07.06.2019 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari:

J.M., nga i ati Z. dhe e ëma B., e vajzërisë K. i lindur me datë *data e lindjes...* në ..., tani me vendbanim në fshatin G., komuna e ..., i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të përfunduare shkollën fillore, punon në bujqësi, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal *numri personal...*, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTORË

Sepse,

Më datën 16.12.2011 në ..., në Qendër të Regjistrimit të Automjeteve e ka vu në lajthim organin kompetent që në një regjistër të vërtetojë një çështje të pavërtetë e paraparë të shërbej si provë e çështjes juridike ose e dokumentit zyrtar, në atë mënyrë që lejen e qarkullimit serb CP08910... me tabela të regjistrimit *tabelat e regjistrimit...*, e cila është lëshuar në emër të makinës së tij për udhëtar të tipit “Opel Astra F-16” viti i prodhimit 1997, e ka përdorur në ditën e cekur në Qendrën për regjistrim në ... ku në bazë të dokumentacionit të tillë të falsifikuar ka marr lejen e qarkullimit CRA nr. 0290..., dhe ka marr targat e regjistrimit *tabelat e regjistrimit...*

Me këtë ka kryer veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme, të parashikuar nga neni 403 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 50, 51, 52, 73, e 74, të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

### G J Y K O N

1. Dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

2. Në mbështetje të nenit 62 par.2, nënpar. 2.7 e lidhur me nenin 69 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet:

Dënim plotësues –Marrja e sendeve dhe atë:

- a. Dokumenteve, lejen e qarkullimit të Serbisë CP08910... dhe leja e qarkullimit të Republikës së Kosovës CRA 0290...
3. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 30€, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
4. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1301/2015 të datës 31.10.2018, kundër të pandehurit J.M. nga ... për shkak të veprës penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme, të parashikuar nga neni 403 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.13.05.2019 ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë si dhe ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur, ka premuar që nuk do të përsëris veprime të tilla, jetoj në kushte të vështira vetëm nga të ardhurat nga bujqësia, jam mbajtës i familjes andaj e luti Gjykatën që t'i merr parasysh këto rrethana.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, ky pranim është në pajtim edhe me provat materiale, gjendjen faktike dhe kualifikimin ligjor të veprës penale, andaj i propozon gjykatës që të merr parasysh pranimin e fajësisë dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh këtë pranim si rrethanë lehtësuese.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti policor i datës 03.12.2014; Deklarata e të pandehurit J.M. e dhënë në polici e dt. 01.12.2014; Lista e gjërave të konfiskuara e datës 03.12.2014; Raporti i Ekspertizës nga Agjenica e Kosovës për Forenzikë e datës 06.03.2014; Polica e sigurimit e datës 16.12.2011; Certifikata mbi rregullsinë teknike të automjetit e dt. 16.12.2011; Libreza e qarkullimit të automjetit e Serbisë nr. CP08910...; Certifikata e regjistrimit të automjetit e Kosovës CRA 0290... Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për

shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo mund të bëjë ankesë sa i përket lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 403 par.1 të KPRK, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur mënyrën e kryerjes së veprës penale, gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë veprë e kishte kryer me dashje dhe me qëllim të përfitimit material për vete.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, si dhe faktin se kjo veprë penale është kryer në vitin 2011 e që nga atëherë ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, më shumë se 8 vite, rrethanat personale, pasi që është mbajtur i familjes, kushtet e vështira pasi që jeton vetëm nga të ardhurat nga bujqësia.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg me kusht ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga vozitja në gjendje të dehur.

Gjykata si në dispozitiv të Aktgjykimi ndaj të pandehurit e ka shqiptuar edhe dënimin plotësues –marrjen e sendit, duke marrë për bazë sigurinë juridike po ashtu është sende që është rezultat i kryerjes së veprës penale dhe i marrë në mënyrë të kundërligjshme, në mbështetje të nenit 282 par.1 të KPP-es, es ku përcakton se pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh edhe gjetjes e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, neni 69 i KPRK-së, përcakton se Sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale do të konfiskohen, andaj për shkak të këtyre konstatimeve gjykata ka qenë e obliguar që të vendos si në dispozitiv të Aktgjykimit që sendet e përdorura të merren -konfiskohen, për shkak edhe të konstatimeve të cekura më lart, në të kundërtën do të legalizohen veprimet e paligjshme të ndërmarrura mbi këto sende dhe rezultatet e këtij sendi, si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, Gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.924/2018, dt.07.06.2019**

Procesmbajtësja  
Selvije Kostërci

**Gjyqtari**

---

**Rahman BEQIRI**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.